



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700258/4

Tiranë ___/___/2017

Lënda : Rekomandohet marrja e masave për shpejtimin e gjykimit të çështjes administrative me Nr.3101-03516-86-2015 akti datë 22.05.2015, e shtetasit Gj. S. nga Shkodra.

Drejtuar : Z. KASTRIOT SELITA
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit

TIRANË

Për dijeni : Z.Gjon STANAJ

Fshati Vuksanaj, Njësia Administrative Shalë

SHKODËR

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e tij datë 23.02.2017, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi Gj. S. nga Fshati Vuksanaj e rrethit Shkodër, ankohet për shkeljen e procedurave gjyqësore, dhe zvarritjen pa shkaqe ligjore të gjykimit të një çështje gjyqësore administrative kundra D.R.S.SH. Shkodër me objekt kundërshtim të vendimeve administrative, nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

Nga verifikimi i kryer nga ana jonë rezulton se me vendimin me Nr.680 datë 17.11.2014, të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, është vendosur si vijon :

Pranimi pjesërisht i kërkesë padisë, shfuqizimi i vendimeve administrative të D.R.S.SH. Shkodër dhe detyrimi i D.R.S.SH. Shkodër ti njohë paditësit si vjetërsi pune për efekt pensioni periudhën nga data 27.12.1972 deri me datën 16.06.1976 në NFP Fierzë sipas librezës së punës.

Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër të saj.

Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet brenda 15 ditëve, nga e nesënja e shpalljes në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Kundra këtij vendimi është ankuar nga pala e Paditur dhe dosja tani ndodhet e regjistruar për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë me datë 22.05.2015, dhe si Relatore me short është caktuar Zj.A.Nasufi e cila për shkak të ngarkesës së madhe të punës nuk ka planifikuar akoma gjykimin e saj.

Duke analizuar arsyet e ankesës së shtetasit Gj. S. dhe kohën e gjatë që ka kaluar nga gjykimi në shkallë të parë të saj nga data 17.11.2014, dhe duke patur parasysh natyrën e gjykimit që ajo ka lidhje me përfitimin e pensionit të pleqërisë së një e drejtë themelore e Njeriut, konkludojmë se për rastin konkret ka vend të ndërhyhet me rekomandim drejtuar Kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, që brenda mundësive ligjore ky

rast të trajtohet si rastë i veçantë, dhe të ndërhyhet e të shpejtohet gjykimi i saj sa më shpejtë në të ardhmen, duke patur parasysh edhe këto rrethana :

Në nenin 42/2 të Kushtetutës së RSH garantohet e drejta e gjykimit të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj, dhe neni 28 i Kodit Procedurës Civile, parashikon faktin se Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt ligjor duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.

Në nenin 49/2 të Ligjit nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", thuhet se: "Gjykatat Administrative e Apelit shqyrtom çështjen brenda 30 ditëve, nga dita e ardhjes së ankimit në Gjykatë ku është paraqitur ankimi. Një veprim i tillë është konsideruar shkelje e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, edhe nga Gjykata Kushtetuese e RSH, me vendimin e saj Nr.85/2015 në të cilin arsyetohet se: "Ligji synon në thjeshtimin e procedurave ligjore me object zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe garantimin e mbrojtjes efektive të drejtës së subjektit dhe të interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor brenda afateve sa më të shpejta dhe të arsyeshme".

Në këto kushte dhe duke u bazuar në kërkesat e nenit 63/3 të Kushtetutës së RSH ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të Drejtave të Njeriut, nga administrata publike", dhe kërkesat e nenit 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet se: "Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të drejtës së shkelur, tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje e të të drejtave dhe lirive", ju

REKOMANDOJMË :

1. Shpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes administrative dt.22.05.2015, të shtetasit Gj. S. nga Shkodra.

2. Mbi masat e marra nga ana juaj, për zbatimin e këtij rekomandimi, lutemi të njoftohemi me shkrim brenda një afati prej 30 ditësh.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI